

Duke Kthyer Vështrimin pas në një Vit Transformues

Të nderuara familje,

Kur isha mësuese, drejtoreshë shkolle dhe udhëheqëse në nivel rrethi, gjithmonë gjeja kohë në fund të vitit shkollor për të reflektuar — si mbi ato që kishim arritur, ashtu edhe mbi ato që na prisnin përpara. Tani, si Kancelare, mezi pres të bëj të njëjtën gjë. Ka qenë një nder të udhëheq këtë komunitet të jashtëzakonshëm nxënësish, stafi dhe familjesh, dhe më vjen mirë që kemi shumë për të festuar ndërsa përmbylлим vitin shkollor 2024–2025.

Këtë vit, ne vazhduam të transformojmë mënyrën e mësimdhënies në lexim dhe matematikë në të gjithë qytetin përmes NYC Reads (NYC Lexon) dhe NYC Solves (NYC gjidh). Po ofrojmë nivele të paprecedenta trajnimit dhe mentorimit për mësuesit tanë, të cilët po bëjnë një punë thelbësore për të siguruar që të gjithë nxënësit — përfshirë nxënësit tanë me aftësi të kufizuara dhe ata që mësojnë në shumë gjuhë — të marrin çdo ditë mësim cilësor, sfidues dhe angazhues.

Gjithashtu kemi zgjeruar programin Student Pathways (Rrugët për Nxënësit), duke shtuar më shumë shkolla dhe drejtime karriere në programin tonë kryesor FutureReadyNYC (Gati për të Ardhmen NYC). Më shumë se 15,000 nxënës morën pjesë në FutureReadyNYC (Gati për të Ardhmen NYC) këtë vit, dhe në dy vitet e fundit, nxënësit tanë kanë fituar mbi 18 milionë dollarë përmes mësimi të bazuar në punë!

Për më tepër, kemi nisur NYCPS Cares, një nismë të re për të mbështetur si nxënësin, ashtu edhe të gjithë familjen. Si pjesë e kësaj pune, po trajnojmë mbi 1,000 Lidhës Familjarë (Family Connectors) që të shërbejnë si përçues të besueshëm të informacionit në komunitetet e tyre dhe të ndihmojnë prindërit e kujdestarët të lidhen me burimet që ofron qyteti. Dhe kjo është vetëm fillimi — për një përmbledhje të plotë të arritjeve, vizitoni faqen tonë të internetit në: schools.nyc.gov/24-25YearInReview.

Na pret gjithashtu shumë punë përpara. Duke filluar këtë vjeshtë, NYC Reads (NYC Lexon) dhe NYC Solves (NYC Gjidh) do të zgjerohen në 186 shkolla të tjera, me NYC Reads që do të nisë për herë të parë edhe në shkollat e mesme. FutureReadyNYC (Gati për të Ardhmen NYC) do të zgjerohet për të përfshirë edhe 50 shkolla të tjera, dhe do të hapim shtatë shkolla të reja, përfshirë Northwell School of Health Sciences (Shkolla Northwell e Shkencave të Shëndetit) dhe HBCU Early College Prep (Përgatitje për Kolegjin e Hershëm HBCU).

Po ashtu po financojmë punësimin e 3,700 mësuesve shtesë për të krijuar klasa më të vogla; po zgjerojmë dhe forcojmë programet 3-K dhe Pre-K, përfshirë ato për nxënësit me aftësi të kufizuara; po zhvillojmë më tej programet tona novatore të specializuara për nxënësit autikë; po vazhdojmë të mirëpresim banorët më të rinj të Nju Jorkut me krahë hapur — dhe shumë më tepër.

Familje, faleminderit që keni zgjedhur Shkollat Publike të Nju Jorkut (NYC Public Schools). E vlerësojmë pafund partneritetin tuaj. Dua gjithashtu të falënderoj vullnetarët dhe udhëheqësit tanë nga familjet dhe komuniteti, përfshirë Këshillat Arsimore të Komunitetit dhe të Qytetit (Community and Citywide Education Councils), Këshillin Këshillues të Prindërve të Kancelares (Chancellor's Parent Advisory Council), Shoqatat e Prindërve dhe Mësuesve/Shoqatat e Prindërve (Parent Teacher Associations/Parent Associations), Ekipet Drejtuese të Shkollës/Drejtoritë Arsimore të Rrethit (School Leadership Teams/District Leadership Teams), Këshillat Këshillues të Prindërve për

Titullin I (Title I Parent Advisory Councils), Ambasadorët e NYC Reads (NYC Lexon) dhe Lidhësit Familjarë (Family Connectors).

Edhe pse viti shkollor po përfundon, puna vazhdon. Jam krenare për gjithçka që kemi arritur këtë vit shkollor dhe jam e entuziazmuar për atë që na pret në vitin e ardhshëm. Shpresoj që edhe ju të ndiheni njësoj.

Në bashkëpunim,



Melissa Aviles-Ramos
Kancelare (Chancellor)